



ÇFARË ËSHTË PAKETA E AR-SIMIMIT DHE E PJSËMARR-JES?

Me përfitimet për arsim dhe pjesëmarrje, fëmijët, të rinjtë dhe të rritur të rinj përfitojnë mundësi më të mira, për t'u zhvilluar personalisht dhe për të marrë pjesë në jetën shoqërore. Përfitimet e ndryshme për arsim dhe pjesëmarrje i përkrahin fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit e rinj nga familjet që kanë nevojë për mbështetje financiare. Me këto përfitime fëmija juaj mund të shfrytëzojë oferta në Kita, shkollë dhe në kohën e lirë, nëse përndryshe ju nuk do të mund t'i përballonit shpenzimet. Pjesëmarrje do të thotë që të gjithë njerëzit mund të jenë të pranishëm në gjithçka dhe të marrin pjesë në jetën shoqërore. Kjo do të thotë për shembull që fëmijë dhe njerëz të rinj ndjekin një klub sporti dhe luajnë futboll së bashku. Ose mësojnë në një shkollë muzike se si luhet një instrument.



KONTAKT & INFORMACIONE TË TJERA

Stadt Duisburg (Qyteti Duisburg)
E-Mail but@stadt-duisburg.de
Telefon 0203 940 00
Web duisburg.de/but



Der Oberbürgermeister (Kryetari i parë i bashkisë)
Amt für Soziales und Wohnen 50-23 BuT
(Seksioni për çështjet sociale dhe banimi 50-23 BuT)
Beekstraße 38
47051 Duisburg

Jobcenter Duisburg
(Qendra e punës Duisburg)
E-Mail jobcenter-duisburg@jobcenter-ge.de
Telefon 0203 302 19 10
Web jobcenter-du.de/but



Mos humbisni! PAKETA E ARSIMIMIT DHE E PJSËMARRJES

MBËSHTETJA EKSTRA PËR FËMIJËT TUAJ

- ✓ Materiale shkollore
- ✓ Mësimi shtesë privat
- ✓ Udhëtime të Kita-s dhe ekskursione të Kita-s
- ✓ Udhëtime të klasës dhe ekskursione shkollore
- ✓ Dreka në Kita dhe në shkollë
- ✓ Shpenzimet për transportin e nxënësve
- ✓ Oferta për kalimin e kohës së lirë

Thjesht aplikoni dhe gati!



KUSH MUND T'I MARRË PËRFITIMET?

Të gjithë fëmijët në ekonominë tuaj shtëpiake mund t'i marrin përfitimet për arsim dhe pjesëmarrje, nëse fëmija juaj merr një prej përfitimeve shtetërore që vijojnë:

- ✗ Shtesa për fëmijë
- ✗ Paratë e qytetarëve (Bürgergeld)
- ✗ Asistencë sociale
- ✗ Ndihmë Sociale
- ✗ Kompensim për banesën
- ✗ Përfitime sipas Ligjit mbi përfitimet e azilkërkuesve

Nxënësit deri në moshën 25 vjeç marrin përfitime për arsim dhe pjesëmarrje, nëse ata ndjekin një shkollë të përgjithshme ose profesionale dhe nuk marrin një pagesë për shkollimin profesional.

Përfitime për pjesëmarrje në jetën sociale dhe kulturore në komunitet marrin të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në nevojë derisa ata e kanë mbushur moshën 18 vjeç.



SI TË APLIKOJ PËR MBËSHTETJE?

Nëse merrni përfitim qytetar, mund ta dërgoni kërkesën në zyrën tuaj të punës.

Në të gjitha rastet e tjera ju aplikoni tek qyteti i Duisburg-ut. Formularët e aplikimit i merrni në internet nën [duisburg.de](https://www.duisburg.de)/but ose në stacionet tuaja të shërbimit për qytetarët. Dokumentet e plotësuara i dërgoni në:

Stadt Duisburg,
Amt für Soziales und Wohnen, Bildung und Teilhabe,
Beekstraße 38, 47051 Duisburg

Gjatë plotësimit dhe përcjelljes së mëtejshme të dokumenteve ju **ndihmojnë** me kënaqësi këshilltaret e BuT: Caktimi i terminit nën **0203 54 42 41 43** ose **butberatung1@werkstadt-duisburg.de**

PËR ÇFARË MUND TË MARRË MBËSHTETJE?



Deri në 180 euro në vit për oferta për kalimin e kohës së lirë si për shembull pjesëmarrjen në klubin e sportit ose ndjekjen e shkollës së muzikës.



Marrja përsipër e kostove të udhëtimit, akomodimit dhe hyrje në rast të ekskursioneve, udhëtimeve shkollore dhe Kita-ve.



Shpenzimet e ushqimeve të drekës së përbashkët për fëmijë dhe të rinjtë që janë në shkollë, Kita ose kujdes ditor gjatë drekës.



Marrja përsipër e shpenzimeve për mësimin shtesë privat, nëse fëmijët dhe të rinjtët kanë vështirësi në shkollë.



Të paktën 150 euro për sende shkollore për vitin shkollor si për shembull për sende sporti, lypse dhe fletore.



Shpenzime për transportin e nxënësve, nëse fëmijët kanë një rrugë të gjatë për në shkollë.